



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 190/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.06.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë “Marsi-Al” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-43442-11-14-2019, me objekt: *“Blerje Uniforma për personelin e shërbimit të urgjencës mjekësorë”*, me fond limit 57.900,605 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 10.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “Univers Promotions” sh.p.k
Autostrada Tiranë-Durrës, Mbikalimi i Rinasit, km 5 Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-43442-11-14-2019, me objekt: “*Blerje Uniforma për personelin e shërbimit të urgjencës mjekësorë*”, me fond limit 57.900,605 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 10.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 10.02.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | | |
|----|-----------------------------|---------------------------|
| 1. | “D&E” sh.p.k | 57.450 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Malbertex” sk.p.k | 58.500 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Marsi&Al” sh.p.k | 65.150 lekë, kualifikuar |
| 4. | “Univers Promotions” sh.p.k | 69.500 lekë, kualifikuar |
| 5. | “Blerina Sadiku” p.f | 74.070 lekë, kualifikuar |
| 6. | “La-Trend” sh.p.k | 77.700 lekë, kualifikuar |
| 7. | “Elektrosek” sh.p.k | 78.500 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 14.02.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërisë “Marsi AL” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

1- Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme te kete plotesuar ne menyre korekt sipas kerkeses.shtojces 8, DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME.

Nga shqyrtimi i Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar te subjektit "Marsi-AL" sh.p.k., ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit, citohen emrat e ortakut si dhe te administratorit te kesaj shoqërie, konkretisht z.P.K dhe te administratorit z.M.T. Nderkohe, qe shtojca 8 "Deklarata mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme", e paraqitur ne kete procedure prokurimi, eshte plotesuar vetem ne nje emer. Pra, ne dyshojme se operatori ekonomik "Marsi-AL" sh.p.k nuk ka plotesuar shtojcen 8 sipas formatit standart te saj, i cili kerkon domosdoshmerisht citimin ne menyre nominale te emrit te cilit anetari te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, te operatorit ekonomik te cilet nuk duhet te jene ose te kene qene te denuar me vendim gjyqesor te formes se prere per asnje nga veprat penale, te percaktuara ne nenin 45/1 te LPP. Ne mendojme se shtojca "Deklarate per permbushjen e kriterëve te pergjithshme" nuk le vend per konfuzion per menyren e plotesimit te saj dhe akoma me tej, keto shtojca jane standarte dhe duhet te plotesohen me perpikmeri ne menyren qe jane konceptuar, per me teper qe jane vetedeklarime te vete OE dhe rrjedhimisht eshte lehtesisht e plotesueshme nga ana e tij.

2- Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme qe permbush KVK (Kriteret e Vecanta te Kualifikimit) pikes 2.f, perkatesisht ne faktin qe te kete paraqitur "Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjië elektrike te kontratave te energjië qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi, per periudhen e parashikuar per te gjitha vendet ku ushtron aktivitet shoqëria. OE Maris-AL shpk referuar Ekstraktit Historik te QKB ka dy adresa ku ushtron aktivitetin.

3- Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme te kete plotesuar ne menyre korekt sipas kerkeses, piken 6. a) te shtojces 2/1 Deklarata e Pavarur. I njejti gjykim sikurse e kemi cituar tek pika 1- e ankeses tone, vlen edhe per kete pike.

4- Per OE Marsi-AL shpk, referuar Ekstraktit Historik ne QKB, ne dyshojme te kete ne objekt te veprimtarise se tij, prodhimin e veshjeve mbrojtese ne pune, apo Personal Protective Equipment (PPE) ,objekt i te cilit eshte ky prokurim i zhvilluar nga AK juaj. Mungesa e ketij objekti veprimtarie hedh poshte paraqitjen e mostrave te kerkuara ne kete procedure, si te prodhuara nga vete OE.

5- Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme qe kampionet e dorezuara dhe 0.5 ml te copes se kerkuar te jene paraqitur te njejta, sikurse kerkohet ne permbushje te KVK, pika 2.3 Kriteret Teknike, pika3), ku thuhet qe "Operatori ekonomik duhet te paraqese per mostrat e kerkuara ne tabelen e meposhtme, deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare, (flete-analize) te leshuara nga laboratore, te cilet duhet te jete te akredituar, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e perdorur per artikullin moster, lendes se pare qe shoqeron ate dhe ajo qe i bashkengjitet flete -analizes duhet te jene detyrimisht te njejta):

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia matëse	Kërkesat e Proçedures
1	Xhup Dimëror	copë	1 (një) "emri i artikullit" 1 (nje) pjesë te lëndës se parë me gjatësi 0,5 ml, dhe gjerësi sa ajo e vet lëndës se parë.
2	Jelek	copë	
3	Pulovër Dimërore	copë	
4	Bluzë me mëngë të shkurtra	copë	
5	Pantallona Dimërore	copë	
6	Pantallona Verore	copë	

Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme se ne permbushje te Specifikimeve Teknike te kete realizuar prodhimin e:

A- Xhup Dimeror

Xhup kerkohet te jete me visibilitet te larte multifunksional; Jaka e larte me cope te dyfishte me kapuc, i cili fshihet brenda Jakes, mbyllet dhe behet pjese e Jakes me nje velkro ngjitese. 6 percina (2 ne pjesen e qafes dhe 4 ne pjesen e bustit); pra, nuk eshte realizuar sipas kerkesave te specifikimeve teknike.

Copa e realizuar me materiale qe perputhen me sistemin e kontrollit Oeko-Tex; pra, mungon certifikata, si dhe shenimi tek etiketa.

Dy xhepa vertikal te mbyllur me zinxhir ne kraharor, me gjatesi 14-16 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy xhepa te pjerret anesor te mbyllur me zinxhir me gjatesi 16-18 cm (ne masen L), me mbrojte reflektive dhe te mbuluar te pjesa e shiritit reflektiv te befit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Xhep per vendosjen e radios ne anen e majte dhe lart te kraharorit, me gjatesi 13-15 cm, me nje pjese me rrjete per degjimin e radios, me mbyllje me velkro nga fart; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Sistemi i rregullimit te gjeresise (llastik me bllokues) nje ne lartesine e belit dhe nje ne pjesen fundore te xhupit pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Perforcime anti-rreshqites mbi shpatulla, ngjyre te zeze me pika te bardha. Ne pjeset anesore zinxhir vertikal anesor per pershtatjen e xhupit me masen e trupit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Kerkohet te kete vize me ngjyre evindentuese, te ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh me vizibilitet te larte, e verdhe, gri, blu etj), ne pjesen e sipërme te jakes, pjesen e sipërme te kapucit, ne lartesine e gjoksit, te kapaket e xhepave te poshtem dhe ne pjesen e pasme te pjesa e shpatullave. Largesia e vizes evidentuese nga qepja e jokes 12-14 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Menget e xhupit te kyçi i dores kerkohen te jene me velkro me ngjitje per rregullimin e madhësisë dhe me llastik per pershtatjen me kyçin e dores; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Kerkohet te kete nje xhep te brendshem drejtkendor ne krahun e majte me mbyllje me ngjitje, ne lartesine e gjoksit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne krah te djathte te gjoksit kerkohet te kete nje velkro horizontale per vendosjen identifikuese te profesionit (mjek, infermier, shofer), me lartesi 1.5-2.5 cm dhe gjeresi 11-13 cm. Poshte velkros te kete nje kuadrat (me permasa lartesi 6-8 cm dhe gjeresi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje direkte ose qepje (pec) te logos se QKUM; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne pjesen e kyceve te dores dhe qafes, kerkohet te kete nje rrip rezistent ne forme unaze, per kapjen me pjesen e brendshme termike; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Astari te jete ne forme rrjete, i perbere me material 94 % PA-poliamid dhe 6 % polyester; pra, mungon analiza e materialit si dhe etiketa me kete perberje,

Ne pjesen e shpines, 2-3 cm poshte vizes evidentuese, te kete te stampuar shkrimin URGJENCA (shkrimi Times Neë Roman, germa kapitale lartesia shkrimit 4-6 cm, distanca ndermjet shkronjave 0.5-1 cm,) dhe poshte saj numrin 127 (shkrimi Times Neë Roman, lartesia e numrave 4-6 cm, distanca ndermjet numrave 0.5-1 cm). Shkrimi te jete i stampuar dhe reflektiv; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy shirita reflektive horizontale paralele me njeri-tjetrin te segmentuar (te nderprere) me teknologji mikro-sferike, te pozicionuara poshte kraharorit dhe ne pjesen e befit, si dhe ne pjesen e kraheve ne lartesine e shiritave te siperpermendur. Permasat e shiritave: 4-6 cm pjesa e sipërme dhe 6-8 cm pjesa e poshtme; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme kerkohet te permbaje: emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit; pra, nuk eshte sipas kesaj kerkese, pasi mungon ne etiketim SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471 :2017 klasa 3, ne fakt etiketa e perdorur nga OE ne dyshojme te kete te shenuar klasa, rrjedhimisht nuk permbush kerkesen e klases 3 te visibilitetit,; mungon ne etiketim SSH EN ISO 11092:2014; mungon certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX e prodhuesit. pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese, nuk jane te shenuara ne etikete

Per veshjen termikete brendshmete xhupit

Veshja termike e brendshme e xhupit e cmontueshme, kerkohet e perbere me mbushje me material poliester dhe veshja me material poliamide me qepje me struktura ne forme rombi. Montimi i veshjes se brendeshme me xhupin kerkohet te behet me ane te dy zinxhirave anesore si dhe me nje shirit ne pjesen e kyceve dhe qafes, ne te cilin eshte e montuar percina qe lejon kapjen me xhupin dimeror; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Perberja fibroze (AATCC 2013 + Reg. 1007/2011): copa e jashtme 100 % poliamid, mbushja 100 % poliester, copa e brendshme 100 % poliamid; pra, mungon analiza si dhe etiketa me kete perberje.

Ne pjesen e belit te kete nje sistem rregullimi me llastik per pershtatjen me madhesine e trupit. Ne gjithe perimetrin dhe ne pjesen e kyceve te kete nje shirit te forte me qepje per bllokimin e materialit mbushes; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

B - Pulover Dimerore

-Pulovra eshte e prodhuar me material poliester, me zinxhir per hapje ne pjesen e perparme, me minge te gjata, eshte e realizuar me material te bute, 100 % poliester, pesha 240 g/m² ±1

O %, kundra pushavitjes, i lemuar nga te dyja anet; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese. -Me jake te larte me lartesi 5-7 cm, me ngjyre te kuqe ne pjesen e perparme dhe blu ne pjesen e pasme (si ngjyra e vizave evidentuese). Vize evidentuese ne gjithe perimetrin e jakes; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Me mbyllje qendrore me zinxhir, me gjatesi 65-67 cm (ne masen L); pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Nje xhep Napoleoni vertikal ne pjesen e djathte te gjoksit, me mbyllje me zinxhir, me gjatesi 14-16 cm. Vize evidentuese me ngjyre te kuqe, ne krah te djathte te zinxhirit, pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Ne pjesen e siperme te krahut te majte te gjoksit, paralel me xhepin e krahut te djathte te kete nje velkro horizontale per vendosjen identifikuese te profesionit (mjek, infermier, shofer), me lartesi 1.5-2.5 cm dhe gjeresi 11-13 cm. Poshte velkros te kete nje kuadrat (me permase lartesi 6-8 cm dhe gjeresi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje te logos se QKUM; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Te kete dy xhepa te pjerret ne pjesen e perparme te poshtme dhe te mbyllur me zinxhir me gjatesi 16-18 cm; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Ne pjesen e pasme ne lartesine e shpatullave kerkohet te kete te stampuar numrin 127 (largetesia e numrave nga qepja e jakes 14-16 cm, shkrimi Times Neë Roman, lartesia e numrave 4-6 cm, distanca ndermjet numrave 0.5-1 cm); pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Ne pjesen anesore te xhepave te poshtem kerkohet te kete nje trekendesh me material elastine dhe elastik per pershtatjen me masen e trupi; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Menget ne pjesen e brendshme te krahut te kete nje shirit te gjere nga sqetulla deri te kyçi me material elastine dhe elastik me dopia qepje, per pershtatje me masen e krahut; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Poshte shpatullave ne pjeset anesore ngjitur me menget te kete nje trekendesh te zgjatur me material elastine dhe elastik per pershtatje me masen e trupi; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Qepjet te jene dopio dhe syzator; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit pra, nuk eshte realizuar sipas kesaj kerkese, pasi mungon analiza per Thurja (SSH EN ISO 4921): Triko me rrjete te krehur, si dhe mungon shenimi per certifikimin sipas standartit 100 OEKO-TEX.

C- Bluze Verore

-Bluze me mende te shkurtra, e prodhuar me material 100% poliestër bikomponentesh, pesha 160 g/m², norma SSH EN 12127, hidrofilik per nxjerrjen e djerses dhe lejimin e transpirimit te trupit nga brenda jashte. Bluza ngelet e thate, si rezultat i perberjes bikomponente, e realizuar; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Bluza kerkohet me jake te larte kemishe me lartesi 6-8 cm e hapur, qe mbyllet me 3 kopsa. Qepje e sheshte. Nje xhep te thjeshte ne anen e majte te gjoksit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Ne lartesine e gjoksit ne krahun e djathte te kete te stampuar ose me qepje direkte ose qepje (pec) logon e QKUM-se, me gjeresi 9-11 cm dhe lartesi 3-4 cm ne skajet me te larta; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normat e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi per certifikimin OEKO-TEX

-Rezistenca ndaj shperthimit (SSH EN I 3938): ≥ 300 Kpa; pra, nuk ka rezistencen e duhur.

-Variacioni i dimensioneve ne larje (SSH ISO 6330): Baze+ 3%, Ind: $\pm$ 3%

-Thurja (SSH EN ISO 4921): Bluze; pra, nuk kathurjen e kerkuar.

-Soliditeti i ngjyrave ne larje 40 grade (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 ,

-Shkarkimi (poliester - pambuku) ≥ 4 ; pra, nuk eshte ne perberjen e duhur.

Soliditeti i ngjyrave ndaj djerses, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04):

Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi $\geq$; pra, nuk eshte ne shkallen e duhur.

Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2; pra, mungon ky dokument.

D- Jelek

Jelek me jake ne forme "V" me perberje fibroze 100 % poliester, ne forme rrjete, transpirant, pesha $145 \text{ g/m}^2 \pm 5 \%$ norma SSH EN ISO 1212 7 dhe rezistence ndaj avujve me pak se $2 \text{ m}^2 \text{ Pa}\ddot{\text{E}}$, sipas normes SSH EN ISO 11092.

Kerkohet te jete me mbyllje qendrore me zinxhir me gjatesi 48-52 cm. Paralel me zinxhirin ne te dy anet te kete nje vize evindetuese, te ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh fosforeshente, e verdhe, gri, blu etjer); pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Te kete dy viza me ngjyre evindetuese, te ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh fosforeshente, e verdhe, gri, blu etj), ne pjeset anesore; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne krah te djathte ne pjesen e gjoksit te kete nje xhep me mbyllje rrethore me gjysem zinxhir me gjatesi 15-17 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne krah te djathte te gjoksit, mbi xhep te kete nje velkro horizontale per vendosjen identifikuese te profesionit (mjek, infermier, shofer), me permasa lartesi 1.5-2.5 cm dhe gjeresi 11-13 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Poshte velkros te kete nje kuadrat (me permasa lartesi 6-8 cm dhe gjeresi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje direkte ose qepje (pee) te logos se QKUM; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne pjesen e shpines te kete te stampuar, qepje direkte ose qepje me qendisje shkrimin URGJENCA (shkrimi Times Neë Roman, germa kapitale lartesia shkrimit 4-6 cm, distanca ndermjet shkronjave 0.5-1 cm, distanca e shkrimit nga bordura e qafes 14-16 cm) dhe poshte saj numrin 127 (shkrimi Times Neë Roman, lartesia e numrave 4-6 cm, distanca ndermjet numrave 0.5-1 cm). Shkrimi te jete reflektiv; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Xhepa per vendosjen e radios ne anen e majte dhe lart te kraharorit, me lartesi 13-15 cm (ne masen L) me nje pjese me rrjete per degjimin e radios, me mbyllje me velkro nga lart, te mbivendosur ne nje xhepa me mbyllje vertikale me zinxhir me gjatesi 14-16 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy xhepa anesore ne pjesen e poshtme te perparme me mbyllje rrethore me zinxhir, poshte shiritit reflektiv horizontal me gjatesi 17-19 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy xhepa vertikale anesore, ne krah te xhepave rrethore me zinxhire dhe kapake, me gjatesi 16-18 cm (ne masen L) ; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Nje shirit horizontal reflektiv te segmentuar (te nderprere) me teknologji mikro-sferike ndermjet xhepave te poshtem dhe te lartem dhe qe vazhdon ne gjithe perimetrin e trupit (edhe ne pjesen e pasme), me lartesi 6-8 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese. Dy shirita vertikale reflektiv te segmentuar (te nderprere) me teknologji mikro-sferike, me gjeresi 4-6 cm, qe nisen nga pjesa e perparme e shiritit horizontal, duke kaluar anash xhepave te siperm, drejt shpatullave dhe perfundojne te pjesa e pasme e shiritit horizontal; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Te pjesa e belit ne pjesen e siperm te xhepave te poshtem, poshte shiritit reflektiv horizontal te kete llastik per pershtatje me masen e trupit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Te gjithe zinxhoret jane te pajisur me terheqes me gjatesi 5-7 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Fundi me material elastik per nje pershtatje me te mire, me bordure te zeze. Pjesa e mengeve dhe jakes me bordure te zeze; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Zinxhoret, kapaku i xhepit te radios dhe bordura e mengeve te jelekut te jene ngjyre e zeze; pra nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi qe materiali i perdorur eshte sipas OEKO-TEX

Copa e thurur me gershetim (SSH EN ISO 4921): Cope e thurur me prishje; pra, nuk ka thurjen e kerkuar.

Rezistenca ndaj shperthimit: ≥ 1000 Kpa; pra, nuk ploteson treguesin e kerkuar. Qendrueshmeria e rrobave (SSH EN ISO 13937-1): Baze ≥ 25 N, Ind ≥ 30 N; pra, nuk ka rezistencen e duhur.

Terheqja e shtresave: ≥ 700 N; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara.

Soliditeti i ngjyrave ne larje 40 grade (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi (poliester - pambuku) ≥ 4 ; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara.

Soliditeti i ngjyrave ndaj djerses, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4 ; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara.

Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, e prodhuesit 2; pra, mungon ky dokument.

E- Pantallona Vere

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi qe materiali i perdorur eshte sipas OEKO-TEX

F- Pantallona Dimerore

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi qe materiali i perorur eshte sipas OEKO-TEX. [...]

Ne rastin konkret mostrat per artikujt, "Xhup dimeror ", "Bluza Dimerore ", "Bluza Verore" "Jeleke" "Pantallona vere ", "Pantallona dimerore" te dorezuara nga operatori ekonomik "Marsi -Al" sh.p.k., nuk mund te vleresohen se jane ne perputhje me kerkesat dhe specifikimet e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST .

Perfundimisht, duke qene se OE "Marsi-AL"shpk sipas pretendimeve tona nuk ka:

Shtojcen 8 te plotesuar sipas kerkesave te DST.

Shtojcen 2/1,te plotesuar sipas kerkesave te DST

Mungesen e objektit te ketij prokurimi ne objekt te veprimtarise se tij,

Mos paraqitjen e vertetimit te OSHEE per te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin OE

Per mosrealizimin sipas kerkesave te Specifikimeve Teknike te mostrave te paraqitura kerkojme shqyrtimin e pretendimeve tona, rrezimin e vendimit te KVO per kualifikimin e OE Marsi -Al" sh.p.k. dhe rrjedhimisht skualifikimin e OE "Marsi -Al" sh.p.k, nga kjo procedure prokurimi.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 254/2 prot., datë 19.02.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën si vijon:

“ [...]

Lidhur me pretendimin e parë:

Komisioni i Shyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin c paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Marsi & Al" SHPK e konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ne permbushje te kriterit te percaktuar ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Shtojca_8_Marsi&Al. Pjese e ketij dokumentacioni eshte "Deklarata mbi Permbushjen e Kriereve te Pergjithshme". Nga verifikimi i kesaj deklarate rezulton se ofertuesi "Marsi&Al" SHPK e dorezuar ate ne perputhje me shtojcen perkatese e me konkretisht, shtojcen 8 te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Ofertuesi ka deklaruar Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, me konkretisht P.K dhe M.T. qe figurojne dhe ne ekstraktin e biznesit.

Lidhur me pretendimin e dytë:

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Marsi & AI" SHPK e konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ne permbushje te kriterit te percakruar ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Vertetim – OSHEE - Marsi&AI". Ne dokumentin "Vertetim debie" nr. 10024 prot, date 03.12.2019, leshuar nga Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike sh.a, evidentohet qe nga verifikimet e kryera ne sistemin e faturimit per kontrata, me konkretisht per 2 kontrata, rezulton te kete ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri ne daten 3.12.2019, duke perfshire faturen koherente te muajit Nentor 2019. Pra, nga verifikimi rezulton se dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi "Marsi & AI" SHPK eshte ne permbushje te kriterit te percaktuar ne "germen f" ne piken 1 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca nr. 9 ne dokumentat e tenderit.

Lidhur me pretendimin e tretë:

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Marsi & AI" SHPK e konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ne permbushje te kriterit te percaktuar ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Shtojca_2-l_Marsi&AI". Pjese e ketij dokumentacioni eshte "Deklarata per paraqitjen oferte te pavarur". Nga verifikimi i kesaj deklarate rezulton se ofertuesi "Marsi & AI" SHPK e ka dorezuar ate ne perputhje me shtojcen perkatese e me konkretisht, shtojcen 2/1 te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Ofertuesi ka deklaruar se ka pergatitur oferten e tij ne menyre te pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bere marreveshje apo pa rrene dakort me asnje konkurrent tjeter.

Lidhur me pretendimin e katërt:

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Marsi & AI" SHPK e konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se ne dokumentacionin e dorezuar te ekstrakt i regjistrit tregtare dhe ekstrakt historik i regjistrit tregtare. Nga verifikimi i ketij dokumentacioni rezulton se objekt i aktivitetit te ofertuesit "Marsi & AI" SHPK jane import-eksport, tregtim me shumice e pakice i artikujve te ndryshe industrial, ushqimor, konfeksione, veshje, kepuce, materiale sportive, pjese kembimi per automjete, mobileri etj, Prodhimin me materiale te veta dhe/ose porositese, perpunimin e te gjitha llojeve te konfeksioneve te veshjeve. Pra nga verifikimi rezulton se ofertuesi "Marsi&AI" SHPK ka dorezuar kete ne perputhje me kriterit te percaktuar ne shtojcen nr 9 " Kriteret e Pergjithshme te Pranimit/ Kualifikimit" germa "a" ne dokumentat e tenderit, duke qene se objekti i prokurimit te kesaj procedure eshte "Blerje Uniforma per personelin e sherbimit te urgjences mjekesore.

Lidhur me pretendimi e pestë:

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Marsi & AI" SHPK si dhe mostrapat e dorezuara nga ofertuesi e konstatoi:

Se pari, nga verifikimi i mostrave te dorezuara nga ofertuesi "Marsi & Al" SHPK ne daten dhe oren e hapjes se ofertave rezulton se nuk ka mangesi si dhe nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin e prokurimit publik, rezulton se ofertuesi ne permbushje kriterit te percaktuar ne piken 3 te seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik", ka dorezuar dokumentacionin me emertim "1.Flete Analize Xhup Dimeror.pdf", "2.Flete Analize Pantallona verore.pdf", "3.Flete Analize Pantallona Dimerore.pdf", "4.Flete Analize Pulover Dimerore.pdf", "5.Flete Analize Bluze Verore.pdf", "7.Flete Analize Jelek.pdf".

Se dyti, komisioni i vleresimit te ofertave me shkresen nr. 72/6 prot., date 23.12.2019, me lende "Kerkese per verifikim", ka kerkuar informacion prane Departamentit te Tekstilit dhe Modes ne Fakultetin e Inxhinierise Mekanike ne Universitetin Politeknik te Tiranes, lidhur me mostrat e paraqitura nga te gjitha operatoret ekonomike pjesemarres nese jane sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dokumentet e tenderit. Organi kompetent, Departamenti i Tekstilit dhe Modes ne Fakultetin e Inxhinierise Mekanike, me shkresen nr. 04 prot.. date 21.01.2020 ka verifikuar karakteristikat teknike te mostrave dhe rezulton se te gjitha mostrat e dorezuara nga te gjitha operatoret ekonomike pjesemarres jane ne perputhje me specifikimet teknike. Gjithashtu, ne lidhje me lenden e pare te artikullit "Xhup Dimeror", nga ana e autoritetit kontraktor perfitues i cili ka hartuar specifikimet teknike, me ane te email te dates 29.01.2020, eshte konfirmuar se ne pjeset e lendes se pare nuk perfshihet "astari" si komponent.

Se treti, specifikimet teknike plotesohen edhe ne terma funksionale nga ky ofertues, duke qene se eshte paraqitur edhe Shtojca 6 "Deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike" si edhe flete analizat e lendes se pare per te gjirhe mostrat e kerkuara nga laboratorit qe ka kryer testimet."

II.5. Në datën 27.02.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 09.03.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 239/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 413/1 prot., datë 06.03.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: 1- Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme te kete plotesuar ne menyre korekt sipas kerkeses se shtojces 8, DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME.

Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të subjektit "Marsi-AL" sh.p.k., në faqen zyrtare të Qendres Kombëtare të Biznesit, citohen emrat e ortakut si dhe të administratorit të kësaj shoqërie, konkretisht z.P.K dhe të administratorit z.M.T. Nderkohe, që shtojca 8 "Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme", e paraqitur në këtë procedurë prokurimi, është plotësuar vetëm në një emër. Pra, në dyshojmë se operatori ekonomik "Marsi-AL" sh.p.k nuk ka plotësuar shtojcën 8 sipas formatit standart të saj, i cili kërkon domosdoshmërisht citimin në mënyrë nominale të emrit të cilit anëtar të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, të operatorit ekonomik të cilet nuk duhet të jenë ose të kenë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP. Ne mendojmë se shtojca "Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme" nuk le vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej, këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikëri në mënyrën që janë konceptuar, për më tepër që janë vetedeklarime të vetë OE dhe rrjedhimisht është lehtësisht e plotësueshme nga ana e tij", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë :

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- *Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- *Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

III.1.2. Në shtojcën 9 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Marsi&Al” shpk, në përmbushje të shtojcës sa më sipër, ka dorëzuar deklaratën me përmbajtje si më poshtë:

“Unë i nënshkruari MT me cilesinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik “Marsi&Al” shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik Marsi&Al shpk shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- Operatori ekonomik Marsi&Al shpk nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*
- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*
MT
PK
nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.
- Operatori ekonomik Marsi&Al shpk nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- Operatori ekonomik Marsi&Al shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- Operatori ekonomik Marsi&Al shpk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në fund të kësaj shtojce është deklaruar se:

“Në cdo rast autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.5. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar të subjektit Marsi&Al rezulton se kjo shoqëri në cilësinë e administratorit ka caktuar MT ndërsa në cilësinë e ortakëve të shoqërisë shfaqet PK.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Marsi&Al” shpk ka dorëzuar shtojcën 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” si më sipër pasqyruar, nga ku rezulton se ka deklaruar administratorin e shoqërisë dhe ortakun e saj. Kjo deklaratë është

plotësuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të parashikuara në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit dhe përmban të gjithë informacionin e kërkuar në këtë shtojcë.

KPP gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e plotësimit në formën e duhur të një shtojce, e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese. Format i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve që plotësojnë cilësitë e përmëndura më sipër dhe për këtë shkak shtojca 8 e dorëzuar nga operatori ekonomik “Marsi&Al” shpk konsiderohet e rregullt pasi përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme qe permbush KVK (Kriteret e Vecanta te Kualifikimit) pikes 2.f, perkatesisht ne faktin qe te kete paraqitur "Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi, per periudhen e parashikuar per te gjitha vendet ku ushtron aktivitet shoqeria. OE Maris-AL shpk referuar Ekstraktit Historik te QKB ka dy adresa ku ushtron aktivitetin”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 9 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1, gërma (f) nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:*

“Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Marsi&Al” shpk, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

“Vërtetim debie” nr.10024 prot, datë 03.12.2019, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Marsi&Al” sh.p.k., ku evidentohet se: Kërkuarisi “Marsi&Al” sh.p.k nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën/kontratën me kod: [...], rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 03.12.2019, pa përfshirë faturën koherente të muajit Nëntor 2019”.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e*

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.2.4. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: *“Kthim përgjigje kërkesës për informacion”*, drejtuar Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkuar të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë: 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara). 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private. 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira. Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të 6 mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qendrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

- 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.*
- 2. Konsumatori rezulton debitor.*
- 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*
- 4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.*
- 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]”*

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Marsi&Al” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim, sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti “Marsi&Al” shpk nuk rezulton debitor për kontratat [...], përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit 10.12.2019. KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Sh.a është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), nr. 1081/1 prot., me objekt: *“Kthim përgjigje kërkesës për informacion”*, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, OSHEE sh.a. ndër të tjera sqaron se *“. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur: 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit. 2.*

Konsumatori rezulton debitor. 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste. 4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së. 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme te kete plotesuar ne menyre korekte sipas kerkeses, piken 6. a) te shtojces 2/1 Deklarata e Pavarur. I njejti gjykim sikurse e kemi cituar tek pika 1- e ankeses tone, vlen edhe per kete pike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 2/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:

(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
- a) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) *është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
- a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;* ☐
 - b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).* ☐
7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
- a) *çmimet ;*
 - b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
 - c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
 - d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

III.3.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

e. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;

f) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

III.3.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Marsi&Al” shpk ka paraqitur shtojcën 2/1 me emërtim *“Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur”* sikundër kërkohet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.3.6. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për deklaratën për paraqitje ofertes të pavarur të operatorit ekonomik “Marsi&Al” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se: “Per OE Marsi-AL shpk, referuar Ekstraktit Historik ne QKB, ne dyshojme te kete ne objekt te veprimtarise se tij, prodhimin e veshjeve mbrojtese ne pune, apo Personal Protective Equipment (PPE) ,objekt i te cilit eshte ky prokurim i zhvilluar nga AK juaj. Mungesa e ketij objekti veprimtarie hedh poshte paraqitjen e mostrave te kerkuara ne kete procedure, si te prodhuara nga vete OE”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 1, gërma “a”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

“Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.[...]

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Marsi&Al” sh.p.k. në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se është paraqitur dokumentacioni:

- “Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit ”Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, ku në pikën 9 ”Objekti i aktivitetit” është përcaktuar: “ Import-eksport, tregtim me shumice e pakice i artikujve te ndryshem industrial, ushqimor, konfeksione, veshje, kepuce, materiale sportive, pjese kembimi per automjete, mobileri etj. Prodhimin me materiale te veta dhe/ose porositese, perpunimin e te gjitha llojeve te konfeksioneve te veshjeve.”
- Shtojca Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku nga shoqëria “Marsi&Al” sh.p.k deklarohet se: ”Operatori ekonomik Marsi&Al shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit[...].”

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.4.4. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët

ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Marsi&Al” sh.p.k., është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “ Marsi&Al” sh.p.k., referuar ekstraktit të QKB-së, përfshin në objektin e aktivitetit të tij objektin e procedurës së prokurimit “*Blerje Uniforma për personelin...*” si dhe ka plotësuar deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku nga shoqëria “Marsi&Al” sh.p.k deklarohet se është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Marsi&Al” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit, e si rrjedhim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme qe kampionet e dorezuara dhe 0.5 ml te copes se kerkuar te jene paraqitur te njejta, sikurse kerkohet ne permbushje te KVK, pika 2.3 Kriteret Teknike, pika3), ku thuhet qe "Operatori ekonomik duhet te paraqese per mostrat e kerkuara ne tabelen e meposhtme, deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare, (flete-analize) te leshuara nga laboratore, te cilet duhet te jete te akredituar, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e perdorur per artikullin moster, lendes se pare qe shoqeron ate dhe ajo qe i bashkengjitet flete - analizes duhet te jene detyrimisht te njejta):*

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia matëse	Kërkesat e Proçedures
1	Xhup Dimëror	copë	1 (një) "emri i artikullit" 1 (nje) pjesë te lëndës se parë me gjatësi 0,5 ml, dhe gjerësi sa ajo e vet lëndës se parë.
2	Jelek	copë	
3	Pulovër Dimërore	copë	
4	Bluzë me mëngë të shkurtra	copë	
5	Pantallona Dimërore	copë	
6	Pantallona Verore	copë	

Per OE Marsi-AL shpk, ne dyshojme se ne permbushje te Specifikimeve Teknike te kete realizuar prodhimin e:

A- Xhup Dimeror

Xhup kerkohet te jete me visibilitet te larte multifunksional; Jaka e larte me cope te dyfishte me kapuc, i cili fshihet brenda Jakes, mbyllet dhe behet pjese e Jakes me nje velkro ngjitese. 6 percina

(2 ne pjesen e qafes dhe 4 ne pjesen e bustit); pra, nuk eshte realizuar sipas kerkesave te specifikimeve teknike.

Copa e realizuar me materiale qe perputhen me sistemin e kontrollit Oeko-Tex; pra, mungon certifikata, si dhe shenimi tek etiketa.

Dy xhepa vertikal te mbyllur me zinxhir ne kraharor, me gjatesi 14-16 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy xhepa te pjerret anesor te mbyllur me zinxhir me gjatesi 16-18 cm (ne masen L), me mbrojte reflektive dhe te mbuluar te pjesa e shiritit reflektiv te befit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Xhep per vendosjen e radios ne anen e majte dhe lart te kraharorit, me gjatesi 13-15 cm, me nje pjese me rrjete per degjimin e radios, me mbyllje me velkro nga fart; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Sistemi i rregullimit te gjeresise (llastik me bllokues) nje ne lartesine e belit dhe nje ne pjesen fundore te xhupit pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Perforcime anti-rreshqites mbi shpatulla, ngjyre te zeze me pika te bardha. Ne pjeset anesore zinxhir vertikal anesor per pershtatjen e xhupit me masen e trupit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Kerkohet te kete vize me ngjyre evindentuese, te ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh me vizibilitet te larte, e verdhe, gri, blu etj), ne pjesen e siperme te jakes, pjesen e siperme te kapucit, ne lartesine e gjoksit, te kapaket e xhepave te poshtem dhe ne pjesen e pasme te pjesa e shpatullave. Largesia e vizes evidentuese nga qepja e jokes 12-14 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Menget e xhupit te kyci i dores kerkohen te jene me velkro me ngjitje per rregullimin e madhesise dhe me llastik per pershtatjen me kycin e dores; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Kerkohet te kete nje xhep te brendshem drejtkendor ne krahun e majte me mbyllje me ngjitje, ne lartesine e gjoksit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne krah te djathte te gjoksit kerkohet te kete nje velkro horizontale per vendosjen identifikuese te profesionit (mjek, infermier, shofer), me lartesi 1.5-2.5 cm dhe gjeresi 11-13 cm. Poshte velkros te kete nje kuadrat (me permasa lartesi 6-8 cm dhe gjeresi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje direkte ose qepje (pec) te logos se QKUM; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne pjesen e kyceve te dores dhe qafes, kerkohet te kete nje rrip rezistent ne forme unaze, per kapjen me pjesen e brendshme termike; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Astari te jete ne forme rrjete, i perbere me material 94 % PA-poliamid dhe 6 % polyester; pra, mungon analiza e materialit si dhe etiketa me kete perberje,

Ne pjesen e shpines, 2-3 cm poshte vizes evidentuese, te kete te stampuar shkrimin URGJENCA (shkrimi Times Neë Roman, germa kapitale lartesia shkrimit 4-6 cm, distanca ndermjet shkronjave 0.5-1 cm,) dhe poshte saj numrin 127 (shkrimi Times Neë Roman, lartesia e numrave 4-6 cm, distanca ndermjet numrave 0.5-1 cm). Shkrimi te jete i stampuar dhe reflektiv; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy shirita reflektive horizontale paralele me njeri-tjetrin te segmentuar (te nderprere) me teknologji mikro-sferike, te pozicionuara poshte kraharorit dhe ne pjesen e befit, si dhe

ne pjesen e kraheve ne lartesine e shiritave te siperpermendur. Permasat e shiritave: 4-6 cm pjesa e sipërme dhe 6-8 cm pjesa e poshtme; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme kerkohet te permbaje: emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit; pra, nuk eshte sipas kesaj kerkese, pasi mungon ne etiketim SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471 :2017 klasa 3, ne fakt etiketa e perdorur nga OE ne dyshojme te kete te shenuar klasa, rrjedhimisht nuk permbush kerkesen e klases 3 te visibilitetit; mungon ne etiketim SSH EN ISO 11092:2014; mungon certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX e prodhuesit. pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese, nuk jane te shenuara ne etikete

Per veshjen termikete brendshmete xhupit

Veshja termike e brendshme e xhupit e cmontueshme, kerkohet e perbere me mbushje me material poliester dhe veshja me material poliamide me qepje me struktura ne forme rombi. Montimi i veshjes se brendeshme me xhupin kerkohet te behet me ane te dy zinxhirave anesore si dhe me nje shirit ne pjesen e kyceve dhe qafes, ne te cilin eshte e montuar percina qe lejon kapjen me xhupin dimeror; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Perberja fibroze (AATCC 2013 + Reg. 1007/2011): copa e jashtme 100 % poliamid, mbushja 100 % poliester, copa e brendshme 100 % poliamid; pra, mungon analiza si dhe etiketa me kete perberje.

Ne pjesen e belit te kete nje sistem rregullimi me llastik per pershtatjen me madhesine e trupit. Ne gjithë perimetrin dhe ne pjesen e kyceve te kete nje shirit te forte me qepje per bllokimin e materialit mbushes; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

B - Pullover Dimerore

-Pulovra eshte e prodhuar me material poliester, me zinxhir per hapje ne pjesen e perparme, me minge te gjata, eshte e realizuar me material te bute, 100 % poliester, pesha 240 g/m² ± 10 %, kundra pushavitjes, i lemuar nga te dyja anet; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Me jake te larte me lartesi 5-7 cm, me ngjyre te kuqe ne pjesen e perparme dhe blu ne pjesen e pasme (si ngjyra e vizave evidentuese). Vize evidentuese ne gjithë perimetrin e jakes; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Me mbyllje qendrore me zinxhir, me gjatesi 65-67 cm (ne masen L); pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Nje xhep Napoleoni vertikal ne pjesen e djathte te gjoksit, me mbyllje me zinxhir, me gjatesi 14-16 cm. Vize evidentuese me ngjyre te kuqe, ne krah te djathte te zinxhirit, pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Ne pjesen e sipërme te krahut te majte te gjoksit, paralel me xhepin e krahut te djathte te kete nje velkro horizontale per vendosjen identifikuese te profesionit (mjek, infermier, shofer), me lartesi 1.5-2.5 cm dhe gjeresi 11-13 cm. Poshte velkros te kete nje kuadrat (me permasa lartesi 6-8 cm dhe gjeresi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje te logos se QKUM; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Te kete dy xhepa te pjerret ne pjesen e perparme te poshtme dhe te mbyllur me zinxhir me gjatesi 16-18 cm; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Ne pjesen e pasme ne lartesine e shpatullave kerkohet te kete te stampuar numrin 127 (largetesia e numrave nga qepja e jakes 14-16 cm, shkrimi Times Neë Roman, lartesia e numrave 4-6 cm, distanca ndermjet numrave 0.5-1 cm); pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Ne pjesen anesore te xhepave te poshtem kerkohet te kete nje trekendesh me material elastine dhe elastik per pershtatjen me masen e trupi; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Menget ne pjesen e brendshme te krahut te kete nje shirit te gjere nga sqetulla deri te kyçi me material elastine dhe elastik me dopia qepje, per pershtatje me masen e krahut; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Poshte shpatullave ne pjeset anesore ngjitur me menget te kete nje trekendesh te zgjatur me material elastine dhe elastik per pershtatje me masen e trupi; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Qepjet te jene dopio dhe syzator; pra nuk eshte e prodhuar sipas specifikimeve teknike.

-Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit pra, nuk eshte realizuar sipas kesaj kerkese, pasi mungon analiza per Thurja (SSH EN ISO 4921): Triko me rrjete te krehur, si dhe mungon shenimi per certifikimin sipas standartit 100 OEKO-TEX.

C- Bluze Verore

-Bluze me mende te shkurtra, e prodhuar me material 100% poliestër bikomponentesh, pesha 160 g/m², norma SSH EN 1212 7, hidrofiliq per nxjerrjen e djerses dhe lejimin e transpirimit te trupit nga brenda jashte. Bluza ngelet e thate, si rezultat i perberjes bikomponente, e realizuar; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Bluza kerkohet me jake te larte kemishe me lartesi 6-8 cm e hapur, qe mbyllet me 3 kopsa. Qepje e sheshte. Nje xhep te thjeshte ne anen e majte te gjoksit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Ne lartesine e gjoksit ne krahun e djathte te kete te stampuar ose me qepje direkte ose qepje (pec) logon e QKUM-se, me gjeresi 9-11 cm dhe lartesi 3-4 cm ne skajet me te larta; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

-Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normat e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi per certifikimin OEKO-TEX

-Rezistenca ndaj shperthimit (SSH EN I 3938): ≥ 300 Kpa; pra, nuk ka rezistencen e duhur.

-Variacioni i dimensioneve ne larje (SSH ISO 6330): Baze+ 3%, Ind: $\pm$ 3%

-Thurja (SSH EN ISO 4921): Bluze; pra, nuk ka thurjen e kerkuar.

-Soliditeti i ngjyrave ne larje 40 grade (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 ,

-Shkarkimi (poliestër - pambuku) ≥ 4 ; pra, nuk eshte ne perberjen e duhur.

Soliditeti i ngjyrave ndaj djerses, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04):

Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi $\geq$; pra, nuk eshte ne shkallen e duhur.

Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, klasa e prodhuesit 2; pra, mungon ky dokument.

D- Jelek

Jelek me jake ne forme "V" me perberje fibroze 100 % poliester, ne forme rrjete, transpirant, pesha 145 g/m² ± 5 % norma SSH EN ISO 1212 7 dhe rezistence ndaj avujve me pak se 2 m² PaË, sipas normes SSH EN ISO 11092.

Kerkohet te jete me mbyllje qendrore me zinxhir me gjatesi 48-52 cm. Paralel me zinxhirin ne te dy anet te kete nje vize evindetuese, te ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh fosforeshente, e verdhe, gri, blu etj); pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Te kete dy viza me ngjyre evindetuese, te ndryshme nga ngjyra e xhupit (p.sh fosforeshente, e verdhe, gri, blu etj), ne pjeset anesore; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne krah te djathte ne pjesen e gjoksit te kete nje xhep me mbyllje rrethore me gjysem zinxhir me gjatesi 15-17 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne krah te djathte te gjoksit, mbi xhep te kete nje velkro horizontale per vendosjen identifikuese te profesionit (mjek, infermier, shofer), me permasa lartesi 15-2.5 cm dhe gjeresi 11-13 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Poshte velkros te kete nje kuadrat (me permasa lartesi 6-8 cm dhe gjeresi 9-11 cm) me ngjitje ose qepje direkte ose qepje (pee) te logos se QKUM; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Ne pjesen e shpines te kete te stampuar, qepje direkte ose qepje me qendisje shkrimin URGJENCA (shkrimi Times Neë Roman, germa kapitale lartesia shkrimit 4-6 cm, distanca ndermjet shkronjave 0.5-1 cm, distanca e shkrimit nga bordura e qafes 14-16 cm) dhe poshte saj numrin 127 (shkrimi Times Neë Roman, lartesia e numrave 4-6 cm, distanca ndermjet numrave 0.5-1 cm). Shkrimi te jete reflektiv; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Xhep per vendosjen e radios ne anen e majte dhe lart te kraharorit, me lartesi 13-15 cm (ne masen L) me nje pjese me rrjete per degjimin e radios, me mbyllje me velkro nga lart, te mbivendosur ne nje xhep me mbyllje vertikale me zinxhir me gjatesi 14-16 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy xhepa anesore ne pjesen e poshtme te perparme me mbyllje rrethore me zinxhir, poshte shiritit reflektiv horizontal me gjatesi 17-19 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy xhepa vertikale anesore, ne krah te xhepave rrethore me zinxhire dhe kapake, me gjatesi 16-18 cm (ne masen L) ; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Nje shirit horizontal reflektiv te segmentuar (te nderprere) me teknologji mikro-sferike ndermjet xhepave te poshtem dhe te lartem dhe qe vazhdon ne gjithe perimetrin e trupit (edhe ne pjesen e pasme), me lartesi 6-8 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Dy shirita vertikale reflektiv te segmentuar (te nderprere) me teknologji mikro-sferike, me gjeresi 4-6 cm, qe nisen nga pjesa e perparme e shiritit horizontal, duke kaluar anash xhepave te siperm, drejt shpatullave dhe perfundojne te pjesa e pasme e shiritit horizontal; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Te pjesa e belit ne pjesen e sipërme te xhëpave te poshtëm, poshtë shiritit reflektiv horizontal te kete llastik per pershtatje me masen e trupit; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Te gjithë zinxhoret jane te pajisur me terheqes me gjatesi 5-7 cm; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Fundi me material elastik per nje pershtatje me te mire, me bordure te zeze. Pjesa e mengeve dhe jakes me bordure te zeze; pra, nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Zinxhoret, kapaku i xhëpit te radios dhe bordura e mengeve te jelekut te jene ngjyre e zeze; pra nuk jane realizuar sipas kesaj kerkese.

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi qe materiali i perdorur eshte sipas OEKO-TEX

Copa e thurur me gershetim (SSH EN ISO 4921): Cope e thurur me prishje; pra, nuk ka thurjen e kerkuar.

Rezistenca ndaj shperthimit: ≥ 1000 Kpa; pra, nuk ploteson treguesin e kerkuar.

Qendrueshmeria e rrobave (SSH EN ISO 13937-1): Baze ≥ 25 N, Ind ≥ 30 N; pra, nuk ka rezistencen e duhur.

Terheqja e shtresave: ≥ 700 N; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara.

Soliditeti i ngjyrave ne larje 40 grade (SSH EN ISO 105 C06): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi (poliester - pambuku) ≥ 4 ; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara.

Soliditeti i ngjyrave ndaj djerses, acideve dhe alkalineve (SSH EN ISO 105- E04): Degradimi ≥ 4 , Shkarkimi ≥ 4 ; pra, nuk permban te dhenat e kerkuara.

Certifikimi sipas standartit 100 OEKO-TEX, e prodhuesit 2; pra, mungon ky dokument.

E- Pantallona Vere

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi qe materiali i perdorur eshte sipas OEKO-TEX

F- Pantallona Dimerore

Etiketa: E vendosur ne pjesen e brendshme dhe qe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masen dhe referencen per matjet anatomike, normal e certifikimit per Pajisjet per Mbrojtjen Personale, udhezimet e larjes, perberjen e copes, vitin e prodhimit pra, nuk permban te dhenat e kerkuara, mungon shenimi qe materiali i perorur eshte sipas OEKO-TEX. [...]

Ne rastin konkret mostrat per artikujt, "Xhup dimeror ", "Bluza Dimerore ", "Bluza Verore" "Jeleke" "Pantallona vere ", "Pantallona dimerore" te dorezuara nga operatori ekonomik "Marsi -Al" sh.p.k., nuk mund te vleresohen se jane ne perputhje me kerkesat dhe specifikimet e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST .

Perfundimisht, duke qene se OE "Marsi-AL" shpk sipas pretendimeve tona nuk ka:

Shtojcen 8 te plotesuar sipas kerkesave te DST.

Shtojcen 2/1, te plotesuar sipas kerkesave te DST

Mungesen e objektit te ketij prokurimi ne objekt te veprimtarise se tij,

Mos paraqitjen e vertetimit te OSHEE per te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin OE

Per mosrealizimin sipas kerkesave te Specifikimeve Teknike te mostrave te paraqitura kerkojme shqyrtimin e pretendimeve tona, rrezimin e vendimit te KVO per kualifikimin e OE "Marsi -Al" sh.p.k. dhe rrjedhimisht skualifikimin e OE "Marsi -Al" sh.p.k, nga kjo procedure prokurimi ", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3, e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mostrat e kërkuara në tabelën e mëposhtme, dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, (fletë-analizë) të lëshuara nga laboratorë, të cilët duhet të jetë të akredituar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia matëse	Kërkesat e Procedures
1	Xhup Dimëror	copë	1 (një) "emri i artikullit" 1 (nje) pjesë te lëndës se parë me gjatësi 0,5 ml, dhe gjerësi sa ajo e vet lëndës se parë.
2	Jelek	copë	
3	Pulovër Dimërore	copë	
4	Bluzë me mëngë të shkurtra	copë	
5	Pantallona Dimërore	copë	
6	Pantallona Verore	copë	

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me adrese: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tiranë.

III.5.2. Lidhur me pretendimet e mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 254/2 prot., datë 19.02.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Marsi & Al" SHPK si dhe mostrat e dorezuara nga ofertuesi e konstatoi:

Se pari, nga verifikimi i mostrave te dorezuara nga ofertuesi "Marsi & Al" SHPK ne daten dhe oren e hapjes se ofertave rezulton se nuk ka mangesi si dhe nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin e prokurimit publik, rezulton se ofertuesi ne permbushje kriterit te percaktuar ne piken 3 te seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik", ka dorezuar dokumentacionin me emertim "1.Flete Analize Xhup Dimeror.pdf", "2.Flete

Analize Pantallona verore.pdf", "3.Flete Analize Pantallona Dimerore.pdf", "4.Flete Analize Pullover Dimerore.pdf", "5.Flete Analize Bluze Verore.pdf", "7.Flete Analize Jelek.pdf".

Se dyti, komisioni i vleresimit te ofertave me shkresen nr. 72/6 prot., date 23.12.2019, me lende "Kerkese per verifikim", ka kerkuar informacion prane Departamentit te Tekstilit dhe Modes ne Fakultetin e Inxhinierise Mekanike ne Universitetin Politeknik te Tiranes, lidhur me mostrat e paraqitura nga te gjithë operatorët ekonomike pjesemarres nese jane sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dokumentet e tenderit. Organi kompetent, Departamenti i Tekstilit dhe Modes ne Fakultetin e Inxhinierise Mekanike, me shkresen nr. 04 prot.. date 21.01.2020 ka verifikuar karakteristikat teknike te mostrave dhe rezulton se te gjitha mostrat e dorezuara nga te gjithë operatorët ekonomike pjesemarres jane ne perputhje me specifikimet teknike. Gjithashtu, ne lidhje me lenden e pare te artikullit "Xhup Dimeror", nga ana e autoritetit kontraktor perfitues i cili ka hartuar specifikimet teknike, me ane te email te dates 29.01.2020, eshte konfirmuar se ne pjeset e lendes se pare nuk perfshihet "astari" si komponent.

Se treti, specifikimet teknike plotesohen edhe ne terma funksionale nga ky ofertues, duke qene se eshte paraqitur edhe Shtojca 6 "Deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike" si edhe flete analizat e lendes se pare per te gjirhe mostrat e kerkuara nga laboratori qe ka kryer testimet."

III.5.3. Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe referuar informacionit e dokumenatcionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor konstatohet se, operatori ekonomik "Marsi&Al" sh.p.k ka paraqitur mostrat dhe fletë analizat për produktet e kërkuara, objekt ankese.

III.5.4. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues "Univers Promotions" sh.p.k nuk parashton fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për të gjithë mostrat në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotëson kriteret e vendosura në DST nga shoqëria "Marsi&Al" sh.p.k, të kualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.5.5. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "*elementet e domosdoshëm të ankesës*" sipas përcaktimeve të nenit 20, "*Forma dhe përmbajtja e ankesës*", pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;*"

III.5.6. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e

Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.5.7. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljet e pretenduara, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku i bazon pretendimet e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërmbushja e kritereve apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.5.8. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.5.9. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.5.10. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.5.11. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Univers Promotions” sh.p.k. nuk merren shqyrtim

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Univers Promotions” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-43442-11-14-2019, me objekt: “Blerje Uniforma për personelin e shërbimit të urgjencës mjekësorë”, me fond limit 57.900,605 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 10.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 239 Protokolli

Datë 27.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha